

VENDIM
Nr. 302, datë 20.4.2016

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1100, DATË 28.12.2015, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2016, PËR ZYRËN E
REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të nenit 13, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, dhe të nenit 29, të ligjit nr. 9936/2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1100, datë 28.12.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Lidhja nr. 1, e përmendur në pikën 1, ndryshohet dhe zëvendësohet me lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Tabelat nr. 2 dhe nr. 3, të përmendura në pikën 2, ndryshohen dhe zëvendësohen me tabelat nr. 2 dhe nr.3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Qëllimi i Politikës së Programit

Qëllimi kryesor i Politikës së Institucionit konsiston në përmirësimin e dhënies së shërbimeve nepermjet përfundimit të procesit të regjistrimit fillestar në të gjithë vendin, si dhe modernizimit të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me qëllim automatizimin e shërbimeve, përditësimin e të dhenave dixhitale të karteles dhe hartës treguese të regjistrimit, duke garantuar informacionin e regjistruar mbi të gjitha pasuritë e paluajtshme në Shqipëri, nëpërmjet një sistemi të sigurt, efikas, bashkëkohor të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme.

OBJEKTIVAT

OBJEKTIVI 1: Përmirësimi Përditësimi i të dhenave dhe Regjistrim Fillestar

OBJEKTIVI 2: Automatizimi i sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

OBJEKTIVI 3: Ndërtimi i infrastruktures së ZRPP nrm kompletimit të zrrp me pajisje elektronike, orendi, dhe rikonstruksionit të ambienteve të ZVRPP




Tabela nr. 2

Në 000/ leke

BUXHETI 2016 I NDRYSHUAR

Pershkrimi	Buxheti 2016 i Ndryshuar	
	Te Ardhura	Shpenzime
	(1)	(2)
Te ardhura nga Shërbimet	2,198,471	
Shpenzime personeli		746,018
Shpenzime korente		313,074
Investime		1,139,379
Fondi rezerve (2% e te ardhurave)		0
Total	2,198,471	2,198,471
Teprica (1)-(2)		0

Tabela nr. 3

BUXHETI I VITIT 2016*Në 000/lekë*

Nr.	EMERTIMI	BUXHETI 2016
I	TOTALI I TE ARDHURAVE	2,198,471
1	Te ardhura jotatimore	2,198,471
	Te ardhura nga tarifat e Sherbimeve te parashikuara per 2016	1,550,000
	Te ardhura te trasheguara nga 2015	648,471
II	TOTALI I SHPENZIMEVE	2,198,471
1	Shpenzime personeli	746,018
	Paga	614,864
	Kontribute per Sigurime Shoqerore	102,054
	Fondi i vecante i pagave	29,100
2	Shpenzime operative	313,074
	Shpenzime te mirembajtjes e te tjera	313,074
3	Shpenzime Kapitale nga te cilat	1,139,379
	Investime kapitale te brendshme	1,139,379
4	Fondi Rezerve	0
	Fondi Rezerve	0
	TE ARDHURA (-) SHPENZIME	0